



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut  
Opština Kacanik  
Municipal Kacanik

01 Nr. 400/01-14264/23  
Kaçanik, 30.06.2023

Në bazë të nenit 42.2(b) dhe (c) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/ 04 Qershor 2008) në shqyrtimin e Draftit të Kornizës Afatmesme Buxhetore (KAB) të Komunës së Kaçanikut për vitet. 2024- 2026, të Qarkores Buxhetore të MF 2024/01, Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e vet të mbajtur më datë 30 Qershor 2023, mori këtë:

## V E N D I M

### PËR APROVIMIN E KORNIZËS AFATMESME BUXHETORE (KAB) E KOMUNËS SË KAÇANIKUT 2024- 2026

1. Me këtë Vendim, APROVOHET Drafti Kornizë, më tekstin e mëtejme, “**Korniza Afatmesme Buxhetore (KAB) e Komunës së Kaçanikut 2024 – 2026**”.
2. Korniza Afatmesme Buxhetore (KAB) e Komunës së Kaçanikut për vitet, 2024-2026, lëshohet në procedurë të Diskutimit publik më qytetarë.
3. Obligohet Drejtoria e Buxhetit dhe Financave të zhvilloj procedurën e Diskutimit publik më qytetarë dhe me Ekzekutivin e Komunës dhe pas saj, rezultatet e diskutimit publik t’ia prezantoj Kuvendit të Komunës, më qëllim të finalizimit të Draftit Kornizë.
4. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është: Korniza Afatmesme Buxhetore (KAB) e Komunës së Kaçanikut 2024-2026, e hartuar nga Drejtoria e Buxhetit dhe Financave, me numër të protokollit 01 Nr. 400/01-14264/23.

#### Me këtë Vendim njoftohen:

1. Kryetari i Komunës;
2. Drejtoria e Buxhetit dhe Financave (përmes kësaj drejtorie njoftohen organet tjera relevante); dhe
3. Arkivi.



Kryesuesi i Kuvendit  
Kemal Murseli